

AKADEMIA E SHKENCAVE  
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE LETËRSISË  
UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOLOGJISË

**SEMINARI XVII NDËRKOMBËTAR  
PËR GJUHËN, LETËRSINË  
DHE KULTURËN SHQIPTARE**

Pëmbledhje e ligjëratave, referimeve,  
kumtesave dhe e diskutimeve.  
Tiranë 16 - 31 gusht 1995

E U R  R I L I N D J A

Victor Friedman

MËNYRA HABITORE NË  
GJUHËN ARUMUNE DHE NË  
GJUHËN SHQIPE-PARALELE  
DHE NDIKIME

Më 1968 albanologu i njohur Wilfried Fiedler (f. 131) ka shkruar se në gjuhën arumune mungojnë format e mënyrës habitore apo përdorimet foljore të ngjashme (në gjermanisht Admirativ-Kommentativsystem), që gjenden në disa gjuhë ballkanike të tjera si shqipja, maqedonishtja dhe bullgarishtja. Petar Atanasov më 1990 (f.220), sipas një vepre të tij nga viti 1984 (që Fiedleri e përmend më 1989), ka shkruar se në gjuhën meglëno-rumune kemi një të kryer të anasjelltë (perfekt i anasjelltë) dmth, me foljen ndihmëse prapa pjesores, dhe me kuptime të ngjashme me mënyrë habitore të shqipes apo me përdorimet jovërtetuese (dmth. habi, dyshim, ritregim, etj. të maqedonishtes dhe bullgarishtes). Vërtet, Caragiu- Marioteanu (1975) në bazën e materialit të Capidanit (1925) ka konstatuar të kryera të anasjellta në meglëno-rumanishte, por ajo i ka trajtuar ato si një të kryer të zakonshme dhe jo si një trajtë të veçantë. Përdorimi i kësaj forme bëhet i qartë në këta shembuj:

(1) *ă bră, tu fost-ăj mări om!*

*ore, ti qenke njeri i madh!*

*a be, ti si bil golem čovek!*

(2) *nu vut- aų hun gıjıt*

*Ata nuk paskan pasur jetë të mirë*

*nemale dobar život*

(3) *ier fost-ăj ăn cătún*

*dje paske qenë në katun*

*včera si bil na selo*

Këtu, fjalët *fost* dhe *vut* janë pjesore kurse *ăj* dhe *aų* janë folje ndihmëse. E kryera mebleno-rumane normale do të ishte *ăj fost* dhe *aų vut*. Paralelja morfologjike me gjuhën shqipe bie në sy, por megjithatë është krejt e

mundshme që këtu kemi të bëjmë me një tendencë tipologjike dhe jo me kontakt midis shqipes dhe megleno-rumanishtes. Megjithëse e dimë se shqiptarët mërguan nëpër Meglen në shekujt e shkuar në udhë për në vende të tjera, nuk ka të dhëna të sakta për këtë shtegim të tyre. Prandaj, për origjinën e së kryerës së anasjelltë në megleno-rumanishten nuk jemi në gjendjen të themi ndonjë gjë më tepër.

Sidoqoftë, deri tani arumanishtja është mbajtur në Ballkanin qëndror si një ishull gjuhësor (ose më saktë si një arqipelag gjuhësor) ku nuk shprehet jovërtetimi me kategori foljore (shih Golab 1984). Përveç arumanishtes, gjuhët e tjera në këtë pjesë të gadishullit (dmth. shqipja, maqedonishtja, bullgarishtja, dhe megleno-rumanishtja) e kanë këtë kategori, e cila nëpërmjet turqishtes i lidh me zonën linguistike më të gjerë të Eurazisë, që karakterizohet me shfaqjen e opozicioneve të kategorisë gramatikore të "statusit" (shih Friedman 1979, 1988). Mirëpo, kur isha në Ohër më 1992, gjeta se në të folmen arumanishte të vllëve nga Frashëri, të ashtuquajturit Farshalotsi, që banonin në Belicën e Sipërme (maqedonisht Gorna Belica, arumanisht Beala di Sus), gjendet një formë foljore jovërtetuese që funksionon si habitoria e shqipes dhe si disa përdorime të formës foljore me -l të maqedonishtes, siç shihet në këta shembuj:

(4) *Un a menu o'spiti bânâez â tu Bitul'i, ma di multu o'râ nu n(â) avem vâzutâ.*

*Aserâ vini nâs la mini ku Mercedes. Mi l'oj di minti : Abe tora tini fuskâ avut om!*

*Një miku im banon në Manastir, por nuk ishim parë shumë vjet. Dje erdhi tek unë me një Mercedes. U habita shumë: Ore tani qenke njeri i pasur!"*

*Eden moj prijatel živee vo Bitola, no odamna se nemame videno. Vçera toj dojde kaj mene so Mercedes. Se šašardisav: A be sega ti si bil bogat çovek!*

(5) *Kum di nu, muntreckâ televizije nalili!*

*Si jo, vështroka lajmet në televizor!*

*kako da ne, toj gledal televizijski vesti!*

(6) *Abe Toma avuskâ zasâ s-nu kântâm kântuc de râmânešti?!*

*Ore, Toma paskësh thënë të mos këndojmë kënga arumune?!*

*Abe Toma imal reçena da ne peeme vlaski pesni?!*

Kur kemi parasysh faktin se deri kohët e fundit banorët e Belicës së Sipërme dinin shqip dhe së paku një pjesë e tyre kishte ardhur më përpara nga Shqipëria, duket se kjo habitore arumune u formua përmes një analizimi abduktiv (sh. Andersen 1973) të habitores së shqipes. Siç dihet, në gjuhën

shqipe habitoria është formuar prej një perfekti të ansjelltë të tipit: pjesorja bashkë me foljen ndihmëse, si p.sh. *ka qenë > qenka*. Në këtë të folme të arumanishtes, duket se morfema *-ka*, e cila në shqipe shënon vetën e tretë njëjës të habitores, qenkësh kuptuar si shenjë e habitores në përgjithësi dhe ishte lidhur me pjesoren arumanishte. Mirëpo, forma e saktë arumune do një shpjegim më me hollësi.

Edhe tema edhe prapashtesa e kësaj habitoreje në gjuhën arumune paraqiten në variante të ndryshme. Perfekti arumun formohet vetën nga baza e aoristit dhe vetëm me pjesoren femërore njëjës. Mirëpo, habitoria arumune ka dy mundësi për bazën e saj, ose aoristi ose imperfekti (por jo që të dyja për një folje) - dhe përveç kësaj, duket se forma e pjesores është shumësi i trajtës mashkullore dhe jo njëjësi i trajtës femërore. Për shembull, pjesorja femërore njëjës e foljes *jam* është *futa* "qenë". Trajta mashkullore e shumësit (me prapashtesën -i dhe palatalizimin e *t*-së) do të jetë *fuc*. Kur shtojmë pjesëzën *-ka*, kemi *fucka* -që me të vertetë është një variant i përdorur i habitores arumune -apo, *fuska*, me ndryshimin e afrikates në spirante, që ndodh edhe në rrethanat e tjera në gjuhën arumune. Në mënyrë të ngjashme nga *-avut* "pasur" kemi *avucka* apo *avuska*, nga *vâdzut* "parë" kemi *vadzuska*. Mirëpo, nga foljet të tjera kemi temën e së pakryerës, për shembull *nâzeska* dhe jo *\*neska* dmth "eci", *dusecka* dhe jo *\*duska* dmth. shkoj; *vanecka* dhe jo *\*vânicka* dmth. "vij", *kumušteska* dhe jo *\*kânâskuska* dmth "di", *becka* dhe jo *\*bicka* dmth. pi, etj. Çështja e temës të së pakryerës ndoshta është e lidhur me faktin se në maqedonishte dhe bullgarishte formimi i një pjesoreje të re nga tema e së pakryerës ka të bëjë me lindjen e luptimeve si habitoria, dhe përveç kësaj, në gjuhën shqipe aoristi mungon në habitore. Çështja e gjinisë dhe numrit të pjesores ndoshta është e lidhur me pjesoren e toskërishtes, që gati gjithmonë del me prapashtesën *-ë*\*

Duhet vënë re se edhe prapashtesa ka variante: *-ka*, *-kâ*, *-krâ*, dhe *-kârâ*, për shembull, si variante me kuptimin "qenka" etj. në këtë të folme kemi *fucka*, *fuska*, *fuska*; *fuskrâ*, *fuskârâ*. Ndërrimi i tingujve /a/ në /â/ ndoshta vjen prej ndikimit të pjesores, osë mund të jetë një tipar dialektor. Duhet shënuar se në të folmen e Përmetit, që nuk është më shumë se njëzet kilometra larg nga Frashëri, trajta e habitores ndërtohet qoftë nga pjesorja e shkurtër, qoftë nga pjesorja e plotë - në këtë të folme zakonisht me prapashtesën -ër. Veç kësaj, *k-ja* e foljes ndihmëse *kam* ndonjëherë është interpretuar si një morfemë e veçantë që ndodhet mes rrënjës dh prapashtesës së pjesores, së cilës i janë shtuar pastaj format e foljes *kam*, apo sipas Lambertzit (1948:48-49), kjo *k-* është një reduplikacion (përsëritje, dyzim) parashikues. Kështu, për shembull, kemi forma të tilla

te Pekmezi (1908: 198) për vetën e parë të habitores : *u bëkam* > *u bërkam* > *u bëkërkam*, *hupkam* > *hupërkam* > *hupërkam* > *hupkërkam* dhe te Lambertzi (1948:48) kemi: *kjënërkam*, *pasërke* dhe *paskërke*, *dhënkërke*, *ditkërke*, *kuptokërke*, *dashkërke*, etj... (sh. Buchholz dhe Fiedler 1987:120) Ndoshta këto variante janë të lidhura me variante arumune.

Kjo habitore arumune ka një kuptim më të gjerë. Një çështje qëndrore në diskutim rreth burimit të kategorisë së jovërtetimit në gjuhën e Ballkanit është pyetja a është kjo kategori një kalk i drejtpërdrejt nga turqishtja, domethënë nga perfekti me parashtesën *-mis*, apo këto janë trajta autoktone, të cilave ndoshta turqishtja u ka dhënë shtysë që të zhvillohej më tej.

Demiraj (1971) ka shkruar për moshën e habitores në gjuhën shqipe, dhe Friedman (1978) sjell të dhëna për një fillim autokton edhe në gjuhët ballkano-sllave. Ky diskutim ka lidhje me pyetjen më të gjerë të tendencës së natyrshme që perfektet të zhvillohen në trajta që janë të markuara për "statusin" e jovërtetimit, e habitës etj. Megjithëse dukuria e habitores në arumanishte kërkon një gjurmim më të thellë e të hollë, sidoqoftë të dhënat që parashtruan këtu janë më tepër si një shembull interesant i një morfeme gramatikore të marrë hua (dmth *-ka* shqipe në arumanishte), si një kalk ballkanik (dmth. përdorimi i pjesores së të pakryerës si temë), si edhe një kundërpërgjigje ndaj mendimit se në arumanishte mënyra habitore nuk ekziston. Kjo dukuri është një shembull krejt pa dyshim ku një kategori e "statusit" siç e shpjeguar më lart, është marrë hua, dhe pikërisht nga gjuha shqipe.

#### □ BIBLIOGRAFI

- Andersen, H 1973. "Abductive and deductive change." *Language* 49.567-95.  
 Atanasov, P. 1990. *Le meglano-roumain de nos jours*. Hamburg: Buske.  
 Buchholz, Oda and Wilfried Fiedler. 1997. *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopädie.  
 Capidan, Th 1925. *Meglenoromanii*. I Bucharest: Academia Romana.  
 Caragiu- Marioteanu, Matilda. 1975. *Compendiu de dialectologie romana*. Bucharest: Editura stiintifica si enciclopedica.  
 Demiraj, Sh. 1971. "Haborja dhe mosha e saj." *Studime filologjike* 8,3.31-49.  
 Fiedler, W. 1968. "Das aromanische Verbalsystem in balkanologischer Sicht." *Beiträge zur rumänischen Philologie*. Berlin. Akademie - Verlag.  
 Fiedler, W. 1989. "Zur Arealtypologie der Futurbildung in der Balkansprachen." *Studien zur Morphologie und Syntax der Balkansprachen II (=Beiträge zur Balkanlinguistik IV)*.

Berlin: Akademie der Wissenschaften der DDR.

Friedman, V. 1978. "On the Semantic and Morphological Influence of Turkish on Balkan-Slavic." *Papers from the Fourteenth regional Meeting: Chicago Linguistic Society*.

Chicago: Chicago Linguistic Society, 108-18.

Friedman, V. 1979. "Toward a Typology of Status: Georgian and Other Non - Slavic Languages of the Soviet Union." *The elements: A Parasession on Linguistic Units and Levels*. Chicago: Chicago Linguistic Society. 339-50

Friedman, V. 1988. "The Category of Evidentiality in the Balkans and the Caucasus." *American Contributions to the Tenth International Congress of Slavists: Linguistics*. Columbus: Slavica. 121-139.

Golab, Z. 1984. *The Arumanian Dialect of Krusevo in SR Macedonia SFR Yugoslavia*. Skopje: MANU.

Lambertz, M. 1948. *Albanisches Lesebuch*. Leipzig: Harrassowitz.

Pekmezi, G. 1903. *Grammatik der albanesischen Sprache (Laut-und Formenlehre)* Vienna.

\*Shih faqen 848